



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE**

RELACION

PËR

EKZEKUTIMIN E VENDIMIT GJYQËSOR TË FORMËS SË PRERË

Midis Bashkisë Korçë me cilësinë e autoritetit kontraktor dhe shoqërisë LANDRI-Y SHPK. në dt. 07.05.2014 është nënshkruar kontrata me objekt “Shitjen e makinerive të dala jashtë përdorimit” ku pas procedurës së shitjes në ankand, kjo shoqëri ka dalë fituese e ankandit.

Kontrata filloi të ekzekutohej sipas parashikimeve por kjo shoqëri gjatë zbatimit të kontratës ka pretenduar mungesë të sasisë të skrapit objekt kontrate, pretendim i cili u kontestua nga Bashkia Korçë. Për këtë qëllim është prishur kontrata duke kërkuar gjyqësisht përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve të palëve kontraktore.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë me vendim 447 dt 21.09.2015 ka vendosur:

Pranimin e pjesshëm të padisë.

Rëzimin e padisë së paditësit “LANDRI-Y” sh.p.k. palë e paditur Bashkia Korçë me objekt “Detyrimi i palës së paditur të përmbushë detyrimin kontraktor të kontratës së shitjes dt. 07.05.2014 duke furnizuar palës paditëse me mallin e përshkruar në kontratë të barazvlefshme me shumën 5.400.000 lekë” si të pabazuar në ligj dhe prova.

Shpenzimet gjyqësore të taksës mbi aktet në shumën 54.000 lekë, mbeten në ngarkim të palës paditëse.

Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes.

Kundër vendimit Nr. 447 dt 21.09.2015 paditësi Landri-y ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë e cila me vendim 254 dt. 07.02.2020 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.447 dt 21.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë

Pranimin e pjesshëm të padisë.

Detyrimin e palës së paditur Bashkia Korçë të përmbushë detyrimin kontraktor të kontratës së shitjes dt. 07.05.2014 dhe të furnizojë palën paditëse me 98.52 ton skrap në vlerën e parapaguar prej 5,136,565.2 lekë pa TVSh.

Shpenzimet gjyqësore I ngarkohen palës së paditur.

Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Bashkia Korçë ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë e cila ende nuk ka dalë më një vendim.

Shoqëria LANDRI-Y SHPK ka vendosur në ekzekutim këtë vendim pranë përmbauesit gjyqësor privat Euglent Osmanaj I cili ka vijuar me procedurat e ekzekutimit të këtij vendimi.

Nga përmbauesi në mënyrë të përsëritur është kërkuar ekzekutimi i detyrimit, përmbushja e detyrimit kontraktor furnizimi me 98.52 ton skrap në vlerën e parapaguar prej paditësit 5,136,565.2 lekë pa TVSh.

Nga ana e Bashkisë Korçë është bërë ekzekutimi i vendimit përse i përket shpenzimeve gjyqësore dhe atyre përmbauesit, ndërkohë nuk është bërë ekzekutimi i detyrimit për kalimin e sasisë së skrapit prej 98.52 ton pasi Bashkia por dhe ndërmarrjet e varësisë nuk e disponojnë gjithë sasisë e skrapit. Sasia totale e skrapit që disponon bashkia dhe ndërmarrjet e varësisë është 41,332 kg në total.

Për këtë qëllim i është kërkuar shoqërisë LARTI Sh.P.K bashkëpunim, për të vendosur në dispozicion të Bashkisë Korçë, sasinë totale diferencë që duhet për ekzekutimin e këtij vendimi.

Shoqëria LARTI shpk ka shprehur mbështetjen e saj duke shprehur dakortësinë për të vendosur në dispozicion të Bashkisë Korçë sasinë prej 57,188 kg skrap.

Këtë sasi skrapit, Bashkia Korçë dhe ndërmarrjet e varësisë duhet t'ia shlyejë shoqërisë në vitet pasardhëse sipas sasisë të grumbulluar në fund të çdo viti dhe nuk do të ndjekin procedurat e shitjes në ankand të sasisë së grumbulluar, deri në ekzekutimin e plotë të sasisë marrë shoqërisë LARTI Sh.P.K.

Për këtë qëllim do të nënshkruhet një marrëveshje bashkëpunimin midis Bashkisë Korçë dhe shoqërisë LARTI SHPK për të përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Sa më lart parashtruam, bazuar në Ligjin 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, Kodi Civil, Kodi i Proçedurës Civile, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Korçë të bëjë miratimin e materialit të paraqitur, ekzekutimin e vendimit gjyqësor Nr. 447 dt 21.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë ndryshuar me vendimin Nr 254 dt. 07.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, autorizimin e kryetarit të Bashkisë Korçë të përpilojë dhe nënshkruajë marrëveshjen e bashkëpunimit me shoqërinë LARTI Shpk për kalimin e 57,188 kg skrap në favor të Bashkisë Korçë për ekzekutimin e vendimit.

Drejtores e Përgjithshme Juridike A. Qeramixhi (Dishnica)

Drejtores e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK: V. Ziko

KRYETAR I BASHKISË

Sotiraq Filo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ . ____

PËR

“EKZEKUTIMIN E VENDIMIT GJYQËSOR TË FORMËS SË PRERË”

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, bazuar në dispozitat e Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile nenin 54, 64 të Ligjit 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar,

KËSHILLI I BASHKISË

VENDOSI

1. Të ekzekutohet vendimii gjyqësor Nr. 447 dt 21.09.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë ndryshuar me vendimin Nr 254 dt. 07.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, duke kaluar sasia 41,332 kg e skrapit që disponon Bashkia Korçë dhe ndërmarrjent e varësisë në favor të shoqërisë LANDR-Y SHPK, për plotësimin e sasisë totale prej 98.52 ton skrap.
2. Sasia që rezulton diferencë nga detyrimi total dhe sasia që disponojmë (98,520 kg- 41,332) = 57,188 kg skrap, do të vendoset në dispozicion të Bashkisë nga shoqëria LARTI SHPK, me nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi.
3. Autorizohet kryetari i Bashkisë Korçë të përpilojë dhe nënshkruajë marrëveshjen e bashkëpunimit me shoqërinë LARTI SHPK.

4. Bashkia Korçë, NSHP, NSHMAÇ dhe institucionet e varësisë, sasinë e skrapit të grumbulluar në fund të çdo vit, detyrohen t'ja kalojnë shoqërisë LARTI ShPK deri në shlyerjen e plotë të detyrimit prej 57,188 kg, duke mosndjekur procedurat e shitjes në ankand të sasisë së grumbulluar, deri në ekzekutimin e plotë të detyrimit.

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes dhe institucionet e varësisë për ekzekutimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

K R Y E T A R

Erjon NEXHIPI

Miraturar me _____vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____